



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 1779 prot

Durrës, më 4.10.2024

VENDIM

Nr. 3, datë 04.10.2024

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të vendimit të Senatit Akademik nr.9, datë 26.09.2024, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 04.10.2024

VENDOSI:

1. Miratimi i Orarit Mësimor për ciklin e parë të studimeve, për semestrin e parë për vitin akademik 2024-2025.
2. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve në marrjen e masave për orientimin e studentëve të vitit të parë në ambjentet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
3. Ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Akademike në marrjen e masave për paisjen e çdo studenti me adresën elektronike zyrtare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. dhe linkun për aksesueshmërinë në Bibliotekën Online të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
4. Ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për hartimin e relacionit në lidhje me vendimin e Senatit Akademik Nr. 9 datë 26.09.2024. "Për miratimin paraprak të shtesës në strukturën e përgjithshme për punësimin e një mjeku të përgjithshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
5. Ngarkimin e Administratorit të Universitetit, në marrjen e masave për përshtatjen e infrastrukturës për t'i ardhur në ndihme studentëve.
6. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve në marrjen e masave, për respektimin e orarit mësimor.
7. Ngarkimin e Zv. Rektores për Anën Mësimore, Drejtorit të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilesisë, si dhe perfaqësuesit të çdo fakulteti që; brënda datës 31.10.2024 të hartojnë draft Rregulloren për krijimin dhe funksionimin e grupeve mësimore, grupeve të përkohshme/ të përhershme Kërkimore Shkencore në Universitetin 'Aleksandër Moisiu' Durrës.

9. Ngarkimin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilesisë dhe Dekaneve të Fakulteteve për ndjekjen e zbatimin të Raportit mbi kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës Brënda datës 20 Tetor 2024, të përcjellin informacion mbi masat e marra.
10. Ngarkimin e Zv. Rektores për Kerkimin Shkencor, në bashkepunim me Dekanet e Fakulteteve për të paraqitur nevojat dhe relacion të detajuar për lektorët e ftuar.
11. Ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike për interpretimin ligjor të propozimit të ardhur nga Fakulteti i Shkencave Politike Juridike me Nr. Prot Nr. 1781 datë 04.10.2024.
12. Miratimin e propozimeve të Dekanëve të Fakulteteve për anetarët e grupit të punës në hartimin e Planit të Zhvillimit Strategjik të UAMD-së për vitet 2025-2030.
13. Ngarkimin e Drejtoise se Kurrikulave dhe Sigurimit te Cilesisë, Drejtroisë së Menaxhimit te projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë, për hartimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të UAMD-së për vitet 2024-2028.
14. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori,
 - Zv. Rektorët,
 - Dekanët e Fakulteteve,
 - Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
 - Drejtorja e Sherbimeve Akademike.
 - Drejtorja e Menaxhimit te Projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë.
 - Drejtorja e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilesisë,
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr.Shkëlqim Fortuzi

